

AKT-THEMELIMI
I SHOQËRISE TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"HOLO Technology and Marketing" shpk

Ortakët e shoqërisë " HOLO Technology and Marketing " shpk janë si më poshtë:

- I. Z. Olsi Poçari , i lindur në Tiranë, në datë 20.03.1984 dhe banues në adresën:
Rr. Muhamet Gjollësja, P.54 ,Tiranë i identifikuar me ID nr. I40320233R,
lëshuar në datë 20.11.2019, person madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të
vepruar (Ortak I vetëm).

VENDOS

Neni 1

Të themelojë një shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar të quajtur:

" HOLO Technology and Marketing " shpk. Shoqëria është një subjekt juridik shqiptar, të cilës I lind e drejta të ushtrojë aktivitetin që nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit të Biznesit (QKB). Shoqëria " HOLO Technology and Marketing " shpk zhvillon aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe me aktet e themelimit të saj.

Neni 2

Shoqëria do të jetë e formës së Shoqërive tregtare me përgjegjësi të kufizuar dhe përballon humbjet deri në kufirin e vlerës së derdhur në kapitalin themeltar.

Neni 3

" HOLO Technology and Marketing " shpk ka selinë e saj në: Rr. Studenti, Vila Nr. 10, Njesia Bashkiake Nr.7, Tiranë

Shoqëria ka të drejtë të krijojë Brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, filiale, agjensi përfaqësimi, seli sekondare, degë, si dhe ti suprimojë ato.

Shoqëria ka gjithashtu të drejtë të krijojë, apo të jetë pjesë e një apo më shumë shoqërive tregtare, pavarësisht nga statusi i tyre juridik, me një pjesëmarrje që do të përcaktohet në çdo rast nga Asambleja e Ortakëve.

Neni 4

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë do të jetë pa afat. Ajo mund të shpërbëhet në çdo kohë në përputhje me dispozitat statutore dhe legjislacionin në fuqi.



Neni 5

Kapitali fillestar themelor i Shoqërisë "HOLO Technology and Marketing " shpk do të jetë 100,000 lekë (njëqindmijë) lekë, me kontributet e ortakut të vetëm:

| Emri Mbiemri | Përqindja | Kuota | Kotributi në lekë |
|----------------|-----------|-------|-------------------|
| Z. Olsi Poçari | 100% | 1 | 100 000 Leke |

Neni 6

Kapitali themeltar është tërësisht në para. Të gjitha kuotat e kapitalit themeltar janë tërësisht të derdhura dhe të nënshkruara nga ortakut themelues. Rritja e kapitalit të shoqërisë nuk është e kufizuar.

Neni 7

Objekti i shoqërisë përfshin ofrimin e shërbimeve:

- a. Objekti i shoqërisë përfshin çdo veprimtari të lejuar nga ligji ose pjesmrrjen në çdo veprimtari apo aktivitet të ligjshëm që mund të kryejë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e krijuar në bazë të legjislacionit Shqiptar.
- b. Më konkretisht por pa u kufizuar në to shoqëria ka për objekt
 - Ofrimi i shërbimeve publicitare dhe të marketingut të të gjitha formave, duke përdorur metoda inovative të komunikimit në distancë, të përdorimit të teknologjive të reja, të mediave të reja, menaxhimi i të dhënave, menaxhim i rrjetit social, zhvillim i strategjive inovative në marketingut, marketing i rrjetit social, përdorimi i kanaleve të ndryshme për marketing, përfshirë shoqëri tregëtare vëndase dhe të huaja.

- c. Si dhe çdo aktivitet shërbimi të parashikuara nga ligji

Objekti i Shoqërisë mund të ndryshohet ose shtohet në përputhje me dispozitat ligjore. Për realizimin e qëllimit të mësipërm shoqëria ka të drejtë:

- t'ju besojë të tretëve pjesë të punimeve të shërbimeve;
- të perfundojë kontrata agjensie me ose pa përfaqësim, me qëllim që të promovojë për llogari të palës tjetër ose të promovohet nga pala tjetër për llogari të saj, aktivitetet dhe shërbimet duke përfshirë të gjitha aktivitetet e ndërmjetësimit të ç'farëdo fushe;

Neni 8

Shoqëria vepron nën regjimin e pronës private dhe merr përsipër të drejta e detyrime vetëm brenda kufirit të kapitalit të saj. Ortakët themelues mbartin rrezikun e veprimtarisë së Shoqërisë në masën e kapitalit të investuar në Shoqëri.



Neni 9

Organet e shoqërisë "HOLO Technology and

Marketing" shpk janë:

-Asambleja e Ortakeve te shoqerise.

-Administratori I shoqerise.

Modalitetet e formimit dhe funksionimit të tyre do të përcaktohen në statutin e shoqërisë.

Administrator i shoqërisë do të jetë ortak i vetëm i kësaj shoqërie: Z. Olsi Poçari , i lindur në Tiranë, në datë 20.03.1984 dhe banues në adresën: Rr. Muhamet Gjollësia, P.54 ,Tiranë i identifikuar me ID nr. I40320233R, lëshuar në datë 20.11.2019, person madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, I cili do të ushtrojë dhe mbajë në mënyrë të veçantë kompetencat e administratorit, për një periudhë prej 5(pesë) vjetësh. Ky afat mund të ndryshojë lirisht në çdo moment që konsiderohet e nevojshme nga asambleja e ortakëve.


Përveç sa është përcaktuar shprehimisht në statutin dhe aktin e themelimit të shoqërisë, Administratori do të ketë tagrin të kryejë veprime bankare në llogarinë e shoqërisë që lidhen me tërheqjen e shumave të depozituara apo çdo veprim tjetër, veprime të cilat mund të kryhen vetëm nga administratori apo persona të tjerë të autorizuar enkas me prokurë të posaçme për këtë qëllim. Administratori është gjithashtu i autorizuar të veprojë në emër të Shoqërisë në formim e sipër deri në regjistrimin e saj pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit. Ai është i autorizuar të firmosi të gjitha aktet dhe të marrë përsipër detyrime në emër të Shoqërisë që rrjedhin prej momentit të regjistrimit të saj si dhe ka të drejtë të delegoj kompetencat e tij personave të tjerë.

Modalitetet për ndryshimin e administratorit si dhe kompetencat e tij rregullohen nga Statuti I shoqërisë, ligji 9901 datë 14.04.2008 " Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" si dhe ligji Nr. 9723 datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Ky Akt- Themelimi është përpiluar në katër kopje me vlerë të njëjtë me origjinalin.

ORTAKËT E SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
(Njëkohësisht dhe administrator I shoqërisë)

Z. Olsi Poçari



Tiranë, më 01.06.2021